



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:130482

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05824135

2024:046667

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi në çështjen penale kundër të akuzuarës A.B me vendbanim në rrugën “S.Ç” në Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me par. 1.4 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP/II.nr.746/23 e datës 09 Shkurt 2024, pas shqyrtimit fillestar dhe publik të mbajtur me datë 03 Qershor 2024 në praninë e Prokurorit të shtetit Ibadete Hamiti si dhe të akuzuarës me mbrojtës me autorizim Av.Vildane Hamiti, me datë 03 Qershor 2024 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 14 Qershor 2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuara:

A.B, nga i ati I. dhe e ëma S. e gjinisë, S., e lindur më ..., në Ferizaj me vendbanim në rrugën “S.Q”, me profesion ekonomiste, teknike dhëmbëve, i gjendjes së mesme ekonomike, e martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë me nr.personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 12.05.2023, rreth orës 20:00 në rrugën “S.Ç” në Ferizaj, saktësisht te dera e hyrjes të banesës së të dëmtuarës, me dashje i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarës M.I, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin rreth një zënke mes fëmijëve të tyre, e

pandehura kishte shkuar në banesën e të dëmtuarës dhe e kishte kapur për fyti, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore në pjesën e qafës, lëndime këto të konstatuara sipas ekspertizës mjekoligjore të datës 27.01.2024.

- **me të cilin veprim ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 me nënpar.1.4 lidhur të KPRK-ës.**

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve 2, 4, 7, 8, 17, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 452,462, të KPP-së, të akuzuarën A.B e,

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro), të cilën gjobë është e obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 € /njëzetë euro/ të gjobës së pa paguar, do t'i llogaritet me 1/një/ ditë burgimi.

E dëmtuara M. I, me vendbanim në rrugën "S.Ç" në Ferizaj, udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ Euro, si dhe në bazë të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 dhe nenit 449 par 2 nënpar 2.9 të KPPK-së për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /njëzet/, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

A r s y e t i m

Historiku procedurës dhe aktakuza

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale kundër të akuzuarës A.B me vendbanim në rrugën “S.Ç” në Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP/II.nr.746/23 e datës 09 Shkurt 2024, duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 236 dhe 240 të KPP-ës, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 03 Qershor 2024, në prezencën e prokurorit të shtetit si dhe të akuzuarat me mbrojtës me autorizim.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi ka udhëzuar të akuzuaran në bazë të nenit 241 par.1 të KPP-ës dhe pasi prokurori i shtetit ka lexuar aktin akuzues dhe pasi gjyqtarja u bind se i njëjti e ka kuptuar aktakuzës, në bazë të nenit 241 par. 4 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 321 dhe 319 të KPPK-ës, të njëjtit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës

E akuzuara me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtore dhe e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës si dhe pranon fajësinë për veprimet e ndërmarra nga ana e saj, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë e vetëdijshme për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me avokaten e saj mbrojtëse, duke shtuar se i vjen keq për këtë vepër penale andaj dhe kërkon falje për këtë çka ka ndodhur pasi është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, ka qenë një veprim i çastit, kërkon nga gjykata t’i ketë parasysh me rastin e vendosjes dhe t’i shqiptoj një dënim më të butë.

Pasi që e akuzuara e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 242 të KPPK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit si dhe mbrojtëses me autorizim të akuzuarës.

Prokurori i shtetit, me rastin e paraqitjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 242 të KPRK-së si dhe provat materiale dhe faktet e çështjes, pas konsultimeve me avokaten e saj mbrojtëse, prandaj i propozoi gjykatës që të njëjtën ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj denim bazuar në dispozita ligjore duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ashtu që me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësja me autorizim e të akuzuarës lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e mbështetë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturës së saj, pasi që një pranim i tillë është bërë pas konsultimit me të si mbrojtëse dhe në bazë të dispozitave të nenit 248 të KPRK-ës, i ka propozuar gjykatës që gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ti vlerësoj rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e thellë, kërkim faljen, nënë e dy fëmijëve, ku kërkon nga gjykata një dënim më të butë respektivisht një dënim me gjobë.

Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 1 të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret si dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: raporti i oficerit i datës 12.05.2023, raportet mjekësore të lëshuar nga QE-Ferizaj të dt.11.05.2023, ekspertiza mjekoligjore e dt.27.01.2024, deklarata e të dëmtuarës M.I të dhënë në prokurori me datë 09.06.2023 deklarata e të pandehurës të dhënë në polici me datë 12.05.2023, si dhe shkresat që gjenden në lëndë.

Me qenë se e akuzuara e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja në bazë të nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprën penale të të akuzuarës dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Gjykata vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarat ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 dhe nënpar.1.4 të KPRK-ës, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, të dëmtuarës me dashje i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin rreth një zënke mes fëmijëve të tyre, e pandehura kishte shkuar në banesën e të dëmtuarës dhe e kishte kapur për fyti, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore në pjesën e qafës, lëndime këto të konstatuara sipas ekspertizës mjeko-ligjore të datës 27.01.2024.

Nga interpretimi dispozitës të nenin 185 arrihet në përfundimin se: ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik, të personit, cenimi i të cilit pas sjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që të kenë prekur shëndetin e personit, konkretisht funksionimin normal të trupit të dëmtuarit, duke i sjellë dëmtime të përkohshme të shëndetit. Pos kësaj kjo vepër penale merr në mbrojtje jetën dhe trupin e njeriut. Në rastin konkret veprimet e dhunës fizike të ndërmarra nga e akuzuara janë përdorimi i forcës ku të dëmtuarën e kishte kapur për fyti në kokë duke cenuar integritetin fizik, psikosocial të dëmtuarës andaj me këto veprime i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko - ligjore.

Caktimi i dënimit për të akuzuarën

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuaran, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës, si rrethanë veçanërisht lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, e cila është bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, kërkim faljen si dhe premtimin se nuk do të përsëris më veprime të tilla, hera e parë që bie ndesh me ligjin kurse në rastin konkret si rrethanë rënduese gjeti faktin se vepra penale është kryer me dashje, ndërsa me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi intensitetin e rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës së mbrojtur pasi që bëhet fjalë për vepër penale kundër jetës dhe trupit, ku me veprimet e tij e akuzuara i ka shkaktuar lëndime të lehta të dëmtuarës siç janë përshkruar në aktakuzë.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarat, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, duke vlerësuar se edhe me dënim kryesor – dënime gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 i KPRK-së, kështu që me dënimin e

shqiptuar si në dispozitiv, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryesit, që do të shërbej në parandalimin të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Kërkesa pasurore juridike si dhe shpenzimet procedurale

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së, pasi që nga të dhënat e mbledhura gjatë zhvillimit të procedurës nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 dhe nenit 449 par 2 nënpar 2.9 të KPPK-së.

Në bazë të të lartecurave u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti Përgjithshëm Penal,

2024:046667 i datës 14 Qershor 2023

Bashkëpunëtori profesional,

Shkelzen Polloviqi

Gjyqtarja,

Mimoza SHABANI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (30) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.